



Data: 14/08/2019

Ref.: 1448/190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 75-të, të mbajtur më 26.07.2019, mori:

## V E N D I M

- I. Akreditohet programi i studimit i Universitetit të Pejës “Haxhi Zeka” për periudhën tre vjecare 1 tetor 2019 - 30 shtator 2022:
  - E Drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane, LLM, 60 ECTS, maksimumi 40 studentë për vit akademik
- II. Nuk riakreditohet programi i studimit:
  - E Drejta Penale, LLM, 60 ECTS
- III. Ndalohet regjistrimi i studentëve të rinj për të gjitha programet e studimit me akreditim valid të Universitetit të Pejës “Haxhi Zeka” për vitin akademik 2019 – 2020 deri në periudhën e riakreditimit të dytë institucional.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## A r s y e t i m i

I. Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional dhe të programeve të studimit të cekura në dispozitivin I të këtij vendimi. AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin e Pejës “Haxhi Zeka”, me datë 12.06.2019 me këtë përmbajtje të ekspertëve: Salvador Rus Rufino dhe Delia Gologan.


Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mledhjen e mbajtur më 26.07.2019 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka" dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me programin e studimit e Drejta Ndërkombëtare dhe Europiane, LLM, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, konstaton se Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka" përmbush kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit dhe rrjedhimisht kanë dhënë rekomandimin pozitiv për akreditim. Sa i përket programit të studimit, E Drejta Penale, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, ndër të tjera ka vënë në pah këto mangësi, të cilat kanë quar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim. Sipas ekspertëve, programi Penal Juridik përqendrohet në një mënyrë shumë teorike dhe akademike, dhe në përgjithësi i mungojnë burimet njerëzore për të siguruar një proces arsimor cilësor në të ardhmen. Sipas tyre është e nevojshme të përmirësohen lëndët e klinikës, aktivitetet praktike për të ndihmuar studentin për karrierën e tyre profesionale dhe organizimin e provimeve për të marrë pozitën e rregullta të zëna nga profesorët të rinj. Sipas ekspertëve, institucioni nuk ka kushte të mira për të promovuar aktivitetet kërkimore të studentëve. Institucioni duhet të punojë shumë për të pajisur bibliotekën, materialet dhe të gjitha mjetet e nevojshme për të garantuar veprimtaritë kërkimore. Ekspertët kanë deklaruar tutje se Masteri në të Drejtën Penale duhet të intensifikojë marrëdhëniet me universitetet e tjera të huaja dhe ekipet kërkimore për të realizuar një shkëmbim efektiv të profesorëve që përdorin programe të tilla si Erasmus + për profesorët e universiteteve. Sa i përket sigurimit të cilësisë, ekspertët kanë deklaruar se proceset e vlerësimit përfshijnë në mënyrë deklarative vetëvlerësimin, por profesorët e angazhuar në programin e Masterit në të Drejtën Penale nuk iu referuan atyre, duke dëshmuar kështu që ato nuk janë një praktikë e zakonshme. Ndërsa sa i përket stafit akademik, ekspertët kanë deklaruar se në Master në të Drejtën Penale duhet të ketë më shumë mësimdhënës dhe të shmangen situatat që një mësimdhënës të ligjërojë më shumë se tetë ECTS, domethënë maksimum dy lëndë. Nga ana tjetër, numri i vogël i profesorëve të masterit bën që një profesor të drejtojë (monitorojë) më shumë se dhjetë projekte të tezave master. Dhe kjo situatë sipas ekspertëve ndikon në cilësinë e hulumtimit të studentëve dhe vonesat në përfundimin e masterit - siç është vërtetuar tashmë për gjeneratën që supozon të përfundojë studimet e tyre këtë vit. Përfundimisht, ekspertët kanë deklaruar se institucioni përmbush pjesërisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit dhe rrjedhimisht nuk kanë rekomanduar akreditimin pozitiv për programin E Drejta Penale.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

